



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1438/3 Prot

Tiranë, më 06.10.2022

VENDIM

Nr. 29, datë 06.10.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, përfaqësues i gazetës komunitare “Nyje.al”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) Formularin e Ankesës nr. 1438 Prot., datë 17.08.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Kamëz” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, bazuar në *site-n* e Bashkisë Kamëz, ku është publikuar njoftimi më datë 15.07.2022 që Këshilli Bashkiak ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz, “KAMZA 2036”, me anë të kërkesës datë 01.08.2022, depozituar në adresën elektronike specialist.informimi@kamza.gov.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion, dokumentacioni, si vijon:

1. *Një kopje e Planit të Përgjithshëm Vendor.*
2. *Informacion për procesin e hartimit të këtij plani, si edhe nëse ka pasur bashkëpunime me grupe të interesit, konsultime me publikun apo çdo procedurë tjetër që përfshin palë të tjera, përpos Bashkisë.*

Autoriteti Publik, me e-mail-in e datës 12.08.2022, i ka kthyer përgjigje ankuesit duke sqaruar ecurinë administrative të Planit të Përgjithshëm, por nuk ka vënë në dispozicion

kopje të dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës për informacion datë 01.08.2022.

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik me e-mail-in e sipërcituar, ankuesi pretendon se nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar sipas pikave të kërkesës për informacion. Ndodhur në këto kushte, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesën e regjistruar me nr. 1438 Prot., datë 17.08.2022, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” (në vijim LDI).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 1438/1 prot., datë 18.08.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar kërkesën për informacion, brenda datës 25.08.2022.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 7445/1 Prot., datë 26.08.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1438/2 Prot., datë 30.08.2022, ka bërë me dije se: *“Këshilli Bashkiak Kamëz ka miratuar Projekt-Vendimin “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz”. Në kuadër të procesit të hartimit dhe miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kamëz në bashkëpunim me subjektin kontraktues Studio “Atelier 4” dhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit ka ezauruar të gjitha fazat që parashikon ligji duke përmbushur të gjithë hapat ligjorë procedurale, përfshirë këtu, edhe hartimin e dokumentacionit tekniko ligjor përkatës si edhe konsultimin me grupet e interesit. Bashkia Kamëz synon të krijojë një mjedis institucional, ekonomik dhe social për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Në funksion të këtij qëllimi është garantuar transparenca gjatë gjithë procedurave ligjore që rregullojnë planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në faqen zyrtare të AKPT-së gjendet i publikuar çdo informacion lidhur me Planet e Përgjithshme Vendore në të gjithë vendin, përfshirë edhe Bashkinë Kamëz”*.

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesi me emailin e regjistruar me nr.1438/3 Prot., datë 02.09.2022 ka vijuar ankimin me pretendimin se edhe në përgjigjen e dërguar pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit nuk ka marrë përgjigje nga Autoriteti Publik sipas objektit të kërkesës për informacion, *pasi citohet se informacioni gjendet i publikuar në faqen zyrtare të AKPT-së, por pas verifikimeve rezulton se kjo e fundit ka në fuqi Planin e Përgjithshëm të vitit 2012. Gjithashtu, Autoriteti Publik informon mbi procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, si shembull përmendimin pohimin*

e realizimit të konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, por nuk njofton për asnjë takim të mbajtur, për vendin kohën apo diskutimet që janë mbajtur.

Me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion, me Urdhrin nr. 133, datë 08.09.2022, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, duke filluar nga data 12.09.2022.

Gjatë inspektimit të ushtruar, në cilësinë e përfaqësuesit të Autoritetit Publik, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Z. Erlend Baballëku sqaroi se: *“Në përgjigje të shkresës me nr. 1438/1 prot., datë 18.08.2022 protokolluar pranë Bashkisë Kamëz administruar me nr. 7445 prot., datë 22.08.2022 është kthyer përgjigje me shkresë me nr.7445/1 prot., datë 26.08.2022. Përsa i përket shkresës për informacion dt. 01.08.2022 Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nuk është në dijeni, kjo kërkesë nuk është depozituar pranë kësaj drejtorie. Drejtoria nuk disponon Planin e Përgjithshëm Vendor Kamëz, por vetëm Draft Plan “Kamza 2036”. Përsa i përket pikës 2, procedurat e Hartimit të Planit janë të përcaktuara në ligjin 107/2014 dhe VKM 686 për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit. Përsa i përket informacionit të kërkuar në lidhje me Planin e Përgjithshëm Vendor ju informojmë se Këshilli Bashkiak Kamëz ka miratuar Projekt-Vendimi ‘Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë’. Ku ky Projekt-Vendim kalon për miratim në Këshillin e Qarkut, me pas kalon për miratim në KKT. Përsa i përket materialit PPV të zbardhur akoma nuk është dorëzuar në Bashkinë Kamëz. Procesverbalet e realizuara në lidhje me konsultimet e realizuara me grupet e interesit i disponon Agjencia e Planifikimit të Territorit (AKPT). Çdo informacion është publikuar në faqen zyrtare e-planifikimi të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit në lidhje me parametrat e ndërtimit. Bashkangjitur do gjeni linkun përkatës <https://akpt.maps.arcgis.com/apps/ëebappvieëer/index.html?id=ff270e99f5be45f19c7b7a1e3e618b27> , që përban informacionin e duhur në lidhje me Planin e Përgjithshëm Vendor .Gjithashtu në faqen e Bashkisë Kamëz gjendet Relacioni për Vlersimin Strategjik Mjedisor i PPV, të cilin e gjeni në linkun https://kamza.gov.al/ëp-content/uploads/2021/06/VSM_relacioni-paraparak.pdf.”*

Me emailin e datës 15.09.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1438/6Prot., datë 15.09.2022 ankuesi ka vijuar përsëri ankimin.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri me shkresën nr. 1438/7 Prot., datë 21.09.2022 ftoi palët në një seancë dëgjimore, me datë 26.09.2022.

Seanca u zhvillua me prezencën e përfaqësueses së dërguar nga ankuesi dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e ankuesit

rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik mbajtën qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, duke shtuar si argument se: “ Ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në nenin 9 të tij, pika d), f) dhe g) përcakton përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit si dhe sygjeruan ankuesin të vlerësonte linkun <https://akpt.maps.arcgis.com/apps/ëebappvieëer/index.html?id=ff270e99f5be45f19c7b7a1e3e618b27>, me pretendimin se ky link përmban informacionin e duhur në lidhje me Planin e Përgjithshëm Vendor.

Pas zhvillimit të seancës, ankuesi me emailin e datës 26.09.2022 regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1438/8 Prot., datë 27.09.2022 ka vijuar ankimin duke sqaruar se: “Ju vëmë në dijeni se pasi riverifikuam emailin e dërguar nga Autoriteti Publik, me datë 16 shtator 2022, informacioni i vënë në dispozicion nuk lidhet me kërkesën tonë. Vegza e parë të çon në faqen e AKPT-së, në të cilën shfaqet një mini-faqe dialoguese, e cila parashtron se PPV-ja e Kamzës nuk është zbardhur ende, përkundër pretendimeve të përfaqësuesit të Bashkisë. Ndërsa, vegza e dytë na jep akses në dokumentin e Vlerësimit Strategjik në Mjedis, hartuar nga Atelier 4, i cili nuk është i njëlloshëm me PPV-në, është dokument krejt tjetër nga ajo çfarë kemi kërkuar. Duke ritheksuar që kërkesa jonë për të shtënë në dorë Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar në Këshillin Bashkiak në korrik të 2022 nuk ka ndryshuar, ju lutemi te merrni parasysh argumentet tona për të mundësuar aksesimin e dokumentit të kërkuar.”

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë, pasi nuk janë në përputhje me parashikimet e LDI.

Në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet që disponon informacionin e kërkuar, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Lidhur me pretendimet e dhëna nga Autoriteti Publik gjatë inspektimit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore se: “Procesverbalet e realizuara në lidhje me konsultimet e realizuara me grupet e interesit i disponon Agjencia e Planifikimit të Territorit”, dhe se Ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në nenin 9 të tij, pika d), f) dhe g) përcakton përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit”, Komisioneri vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi Autoriteti Publik në rastet kur konstaton se nuk e disponon informacionin e kërkuar, delegon kërkesën pranë autoritetit kompetent bazuar në pikën 2, të nenit 12 të LDI, e cila

përcakton: “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”, veprim ky, i cili nuk rezulton të jetë bërë nga ana e Autoritetit Publik.

Gjithashtu, neni 12 dhe 13 i Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar përcakton se: “Neni 12, Përgjegjësitë e Këshillit Bashkiak

1. Këshilli Bashkiak, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për miratimin e mjeteve financiare të akorduara nga bashkia për zbatimin e këtij ligji.

2. Këshilli bashkiak është përgjegjës për të:

a) miratuar nismën për hartimin apo rishikimin e planit të përgjithshëm vendor;

b) miratuar planin e përgjithshëm vendor;

c) monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e planit të përgjithshëm vendor dhe planeve sektoriale në nivel vendor;

ç) monitoruar respektimin e kuadrin ligjor për pjesëmarrjen dhe shqyrtimin publik të dokumenteve vendorë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, gjatë procesit të hartimit të tyre;

dh) shqyrtuar në bazë vjetore Raportin Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektivave të deklaruara në dokumentet e planifikimit në nivel vendor.

Neni 13, Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë

1. Kryetari i bashkisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për:

a) zhvillimin e territorit vendor, përmes hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit të territorit;

b) ndërmarrjen e nismës për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve vendore të planifikimit;

c) hartimin apo rishikimin e dokumenteve të planifikimit të territorit në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe, sipas rastit, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe duke iu përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit;

ç) koordinimin mes institucioneve publike dhe alokimin e burimeve njerëzore të nevojshme për hartimin e dokumenteve të planifikimit në nivel vendor;

d) dorëzimin dhe prezantimin e planit të përgjithshëm vendor pranë AKPT-së, për të verifikuar përputhshmërinë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe normat teknike të planifikimit;

dh) miratimin e planeve të detajuara vendore.

2. Të gjitha institucionet publike në nivel qendror dhe lokal janë të detyruara të ndihmojnë autoritetin vendor përgjegjës për planifikimin dhe administrimin e territorit të bashkisë, me dokumentacionin mbështetës të sektorëve të ndryshëm, të nevojshëm për përgatitjen e dokumenteve vendore të planifikimit.”

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njërive të qeverisjes vendore i u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen

Vendore”, i ndryshuar. Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësive vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, interesi publik në marrjen e informacionit në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe i lartë dhe si rrjedhojë, ky dokumentacion i cili disponohet në kuadër të veprimtarisë institucionale të Autoritetit Publik, duhet të ishte bërë publik duke garantuar kështu njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për sa më sipër, gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim. Në pikën 6 të këtij neni, parashikohet se: “...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”. Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar individualisht kërkesën për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim i cili nuk rezultoi të jetë bërë.

Si përfundim, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit: “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, lidhur me ankesën e Z. Ronald Qema kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1438 Prot., datë 17.08.2022, të z. _____, përfaqësues i gazetës komunitare “Nyje.al”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Kamëz”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 01.08.2022, konkretisht: (“1. Një kopje e Planit të Përgjithshëm Vendor. 2. Informacion për procesin e hartimit të këtij plani, si edhe nëse ka pasur bashkëpunime me grupe të interesit, konsultime me publikun apo çdo procedurë tjetër që përfshin palë të tjera, përpos Bashkisë”), brenda datës 13.10.2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 06.10.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

